



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 2332/2020  
Data: 15.04.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 17.03.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Edon Curri (Drejtor i Administratës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i planit të punës së Komiteti konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2020 .
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 .
4. Shqyrtimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2019.
5. Njoftim për mbi aktivitetet e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.
6. Njoftim për aktivitete e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **2. Shqyrtimi i planit të punës së Komiteti konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2020 .**

**Kryesuesi** thekson:- komiteti është konstituar dhe ka hartuar planin e punës për vitin 2020. Ky komitet është themeluar në bazë të rekomandimeve që janë dhënë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në shtatorë kanë planifikuar me diskutuar për buxhetin dhe a bëhet fjalë për buxhetin e vetë të cilët kërkojnë me pasur apo për buxhetin e komunës për shkak se nuk ishte e qartë kjo pikë që e kanë paraparë. Sa është numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara në komunën e Hanit të Elezit. A është funksionale zyra e Hendikosit.

**Kryesuesi** thekson:- sa i përket buxhetit bëhet fjalë për kërkasat e veta të cilat do t'i adresojnë në kuadër të buxhetit komunal. Në plan të punës e kanë paraparë edhe themelin e Hendikosit. Sa i përket numrit të personave me aftësi të kufizuara komiteti besojë që do bënë identifikimin dhe për numrin më detalishtë i ka Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Zyra e Hendikosit nuk është funksionale dhe përgjegjësinë e ka marr znj.Nerxhivane Berisha.

**Teuta Shkreta** thekson:- a ka zyre Hendikosi në Han të Elezit.

**Mallzum Qajani** thekson:- duhet të dallohet komiteti me shoqatën e Hendikepëve për shkak se shoqata është OJQ , ndërsa komiteti është për mbrojtjen e interesave të asaj kategorie. Zyra e Hendikosit ekziston por i kanë ndërruar me zyrën e fotografistit dhe asnje individë nuk ka dalur vullnetarisht për ta udhëhequr Hendikosin dhe komuna është munduar me gjet person që është vullnet mirë dhe që donë ta udhëheqë në mënyrë që dëshiron por është pak problematike. Për me udhëhequr e ka marr znj.Nerxhivane Berisha dhe do komuna ta ndihmon por është pak problematike. Për me udhëhequr e ka marr znj.Nerxhivane Berisha dhe do të shohim që gjatë vitit 2020 si do të zhvillohet kjo dhe a do të bëhet e pavarur si OJQ për shkak se funksionon si nëndegë e Kaçanikut. Sa i përket buxhetit është kategori e veçantë dhe do të kenë kërkesa për shpenzimet buxhetore.

**Teuta Shkreta** thekson:- sipas informatave që kam ata nuk janë të pëlgimit që e kanë ndërruar zyrën dhe tash duhet ta dimë se a paguajnë për shfrytëzimin e zyrës dhe si funksionon ajo zyre për shkak se duhet me ju dhënë qasje për çdo send. Zyrën të cilën e kanë pasur me herët janë takuar për shkëmbim të përvojave apo për bashkëbisedime të ndryshme dhe me sa jam e informuar nuk janë të kënaqur me lokalit që është në atë pjesë dhe unë nuk e shohë të arsyeshme që lokalit i tyre me qenë në atë pjesë.

**Mallzum Qajani** thekson:- ajo është OJQ dhe vendos vetë ne nuk mund ta ndalim për çështje të zyrës se pse e kanë ndërruar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- parafolësja e ka mirë në atë kuptim për shkak se janë kategori më e veçantë pavarsisht se a kemi obligim ligjorë apo jo është mirë të kemi obligim moral për subvencionimin e tyre sepse për këtë arsy që është themeluar ky komitet. Me që është komitetit i themeluar dhe ka të bëjë me persona me aftësi të kufizuara është mirë me krijuar një ndërlidhje shumë të ngushtë me ta sikur se janë komitetet e tjera konsultative sepse për këtë arsy që është formuar ky komitet. Të gjithë e dimë kur ishte z.Imer Suma ka funksionuar shumë mirë dhe ne duhet ta bëjmë funksionale. Duhet të jemi më seriozë në mënyrë që t'ju krijojmë kushte më të mira. Nuk po e dimë formën se si e kanë ndërruar zyrën por qasja për atë kategori nuk është e mirë aty.

**Kryesuesi** thekson:- zyrën të cilën e kanë pasur ka qenë me hyrje të veçantë dhe në zyrën tash që është problem është qasja me hyrë në zyre dhe duhet t'i krijohen kushtet. Komiteti në fjalë besoj që do të merret edhe me këtë çështje. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.**

#### **3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 .**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te mbajtja e mbledhjeve është mirë të shënohen datat e mbledhjeve. Rekomandimet të cilat i kanë dhënë më pëlqyen dhe do të ishte mirë që me i zbatuar rekomandimet apo të paktën me dhënë sqarim nga ekzekutivi se sa prej këtyre rekomandimeve ishin të arsyeshme dhe sa janë zbatuar. Fjala aromë të përmirësohet dhe të jetë kundërmon erë e keqe.

**Mallzum Qajani** thekson:- komiteti për komunitete është pjesë e kuvendit të komunës dhe është komiteti obligueshëm dhe nëse ata kanë diçka mund t'i propozojnë kuvendit të komunës nëse është me rëndësi apo kryetarit të komunës.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Shqyrtimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- vitin e kaluar u kam bërë ftesë komiteteve konsultative me raportuar në kuvend por nuk kanë marr pjesë dhe mundemi me ju bërë ftesë për mbledhjen tjetër por nuk di a do të marrin pjesë. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- komiteti konsultativ për shërbime publike ka dhënë rekomandim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që përmes inspektoratit të komunës të shpeshtohen inspektimet nëpër shitoret ushqimore por nuk e ka dhënë arsyetimin e këtij rekomandimi se cila është arsyja që duhet të inspektohen. Te Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomikë i ka rekomanduar Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë që të bëj iniciimin e procesit të riciklimit të mbeturinave të paktën në ndonjë shkollë apo institucion të Komunës së Hanit të Elezit , por unë mendoj që në vend të fjalës riciklim duhet të zëvendësohet fjala ndarje për shkak se fjala riciklim është diçka tjetër në krahasim me fjala selektim dhe është mirë që të përdoret fjala ndarje. Te rekomandimi që i është dhënë Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë që të bëj pastrimin e rrugës nga mbikalimi që shkon në drejtim të Urës së Seçishtës nga barërat e ndryshme duhet të ndryshohet dhe të jetë nga barnishtat e ndryshme. Është mirë që mos të përsëritet fjala rekomandim. Te komitetit Konsultativ për Arsim Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i është dhënë rekomandim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që të planifikon mjete financiare për shkuarjen e stafit të QKMF-së në Shqipëri sepse edhe ky staf duhet të trajtohet njëjtë sikur institucionet e tjera të komunës. Për këtë rekomandim është dashur me modifikuar arsyeshmërin e shkuarjes sepse nuk besojë që dikush është kundër shkuarjes së tyre por duhet ta ketë një arsyeshmëri. Është dhënë rekomandim Drejtorisë për Arsim Kulturë Rini dhe Sport që të bënë kabinetin në shkollën e mesme "Dardania" por nuk është definuar se cilin kabinet.

**Teuta Shkreta** thekson:- është dhënë rekomandim për mirëmbajtjen e varrezave që më pëlqeqi , mirëpo është dhënë rekomandim që të bëhet rregullore për mirëmbajtjen e varrezave.

**Kryesuesi** thekson:- OSB-ja ka organizuar takim me komitetin konsultativ për persona me aftësi të kufizuara dhe ftesë për takim kanë pasur edhe kryesueset e komiteteve konsultative dhe nuk kanë marr pjesë, ndërsa të komunës së Kaçanikut kanë marr pjesë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA RAPORTI I PUNË SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 5. Njoftim mbi aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- këshilli mbanë mbledhje për çdo muaj dhe janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe nuk ka pasur diçka që e ka shqetësuar komunën e Hanit të Elezit gjatë vitit 2019. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në pjesëmarrje të mbledhjeve vërejta që ka marr pjesë edhe përfaqësuesi i Hendikosit dhe nuk e di se në cilat mbledhje ka marr pjesë. Është shënuar që është diskutuar çështja e fushatës zgjedhore

**Mallzum Qajani** thekson:- çështja e fushatës ka të bëjë me zgjedhjet parlamentare.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA NJOFTIMI MBI AKTIVITET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR IGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 6. Njoftim për aktivitete e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- raport kanë dorëzuar gjashtë administratorë, dy prej tyre kanë njoftuar se deri në mbledhje të kuvendit do ta përcjellin , ndërsa pesë tjerë kanë deklaruar se nuk paraqesin raport. Mund të shihet se vetëm rapporti i administratorit të fshatit Gorancë është më i detajuar. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ekziston mundësi me i obliguar për me paraqitur raport. Disa këshilla të fshatrave nuk kanë paraqitur raport edhe vitet e kaluara a ke mundur me i obliguar.

**Edon Curri** thekson:-është problem me i obliguar sepse në këtë muaj e kryejnë mandatin e tyre dhe do të bëhet rizgjedhja po për shkak situatës së virusit ndoshta do të shtyhen.

**Mallzum Qajani** thekson:- janë në fund të mandatit dhe kjo çështje është pak problematike sepse po të ishin në fillim të mandatit komuna e Hanit të Elezit do të mbante mbledhje me atë fshatë dhe komunitetin që e ka zgjedhë dhe me potencuar se përfaqësuesi i juve nuk i interpretion interesat e juve si fshatë dhe ju mund ta obligoni apo mund ta ndërroni dhe pastaj komuniteti vendosë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në rregullore parashihen procedurat ashtu siç parashihet zgjedhja parashihet shkarkimi.

**Teuta Shkreta** thekson:- administratori mund t'i paraqet problemet e fshatit duke filluar prej çështjes së ujit, çështjen e nxënësve të cilët ndjekin mësimin në atë shkollë të fshatit dhe kanë shumë gjëra për me i diskutuar për fshat.

**Mallzum Qajani** thekson:- do të ishte më mirë me krijuar një strukturë të raportimit në mënyrë që ata me plotësuar , në mënyrë që gjitha raportet me qenë identike

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA NJOTIMI PËR AKTIVITETE E KËSHILLAVE TË FSHATARVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

##### **7. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nora Xhoni** thekson:- është mirë të diskutohet për çështjen e koronavirusit.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që ta propozojmë si pikë të rendit të punës për mbledhje të kuvendit të komunës.

**Teuta Shkreta** thekson:- është mbajtur mbledhja e këshillit që është formuar për parandalimin e koronavirusit kërkoj informacion rrëth takimit të cilin e keni pasur.

**Mallzum Qajani** thekson:- është mbajtur mbledhja e parë e këshillit dhe ai këshill do të përcjellë gjendjen në nivel të komunës dhe nëse paraqitet gjendja e jashtëzakonshme do të ngitet niveli. Këshilli më shumë ka marr informata nga drejtori i QKMF-së dhe ka apeluar që qytetarët të zbatojnë vendimet e neverisë së Kosovës për shkak se janë në interes të qytetarëve.

**Kryesuesi** thekson:- si pikë e rendit të punës propozoj për kuwend të diskutohet informatë rrëth gjendjes aktuale për koronavirusi. Këtë pikë e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të myllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**

